



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: E enjte, 23 tetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Protokollit për
Kontakte**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Hashim Thaçit (Çështja 12)

Sofi Menegon

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Rodni Dikson KC

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(2) dhe (4), 23(1), dhe 40(2) dhe 40(6)(f) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 80 dhe 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar ("Protokolli për Kontakte në Çështjen 06").¹
2. Më 27 dhjetor 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06.²
3. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykues lëshoi Urdhrin për Zhvillimin e Gjykimit dhe përfshiu në të Protokollin për Kontakte në Çështjen 06.³
4. Më 27 nëntor 2023, Trupi Gjykues ndryshoi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 duke e shtrirë zbatimin e tij për kontakte me dëshmitarët pas dhënies së dëshmisë ("Vendimi për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte në Çështjen 06").⁴

¹ KSC-BC-2020-06, F00854, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose të Pjesëmarrësit Kundërshtar*, 24 qershor 2022, publik.

² IA024/F00019, *Vendim në lidhje me Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit Kornizë për Trajtimin e Informacionit Konfidencial gjatë Hetimeve dhe Kontakteve ndërmjet një Pale ose Pjesëmarrësi dhe Dëshmitarëve të Palës ose Pjesëmarrësit Kundërshtar*, ("Vendimi i Apelit lidhur me Protokollin për Kontakte në Çështjen 06"), 27 dhjetor 2022.

³ F01226/A01, Trupi Gjykues, *Shtojca 1 e Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, para. 71.

⁴ F01960, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar lidhur me Kontaktet me Dëshmitarët pas Dhënies së Dëshmisë*, 27 nëntor 2023.

5. Më 18 shtator 2025, Mbrojtja e Hashim Thaçit (“z. Thaçi”) (“Mbrojtja e Thaçit”) në çështjen KSC-BC-2020-06 (“Çështja 06”) dhe në KSC-BC-2023-12 (“Çështja 12”) dorëzoi kërkesën për ndryshimin e Protokollit për Kontakte në Çështjen 06 (“Kërkesa”).⁵
6. Më 29 shtator 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dhe Mbrojtësi i Viktimave iu përgjigjën Kërkesës (përkatësisht “Përgjigjja e ZPS-së”⁶ dhe “Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave”,⁷).
7. Më 7 tetor 2025, Mbrojtja e Thaçit u kundërpërgjigj (“Kundërpërgjigjja”).⁸

II. PARASHTRIMET

A. KËRKESA

8. Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjykses të ndryshojë Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 në mënyrë që ai të mos zbatohet për disa nga dëshmitarët e ZPS-së që janë dëshmitarë në Çështjen 06 dhe Çështjen 12 (“dëshmitarët e njëjtë”), duke përfshirë ndër të tjerë dhe ata që përmenden në Shtojcën 1 të Kërkesës.⁹
9. Mbrojtja e Thaçit argumenton se Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 përshkruan një regjim shumë më të rëndë se regjimi i përdorur në Çështjen 12 në lidhje me kontaktet ndërmjet një pale dhe një dëshmitari të palës kundërshtare, duke përfshirë pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarëve.¹⁰ Ajo parashtron se,

⁵ F03488, Mbrojtësi i Specializuar, *Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte*, 18 shtator 2025, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe ex parte.

⁶ F03499, Prokurori i Specializuar, *Përgjigjja e Prokurorisë ndaj ‘Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte me Shtojcën 1 konfidenciale dhe ex parte’*, 29 shtator 2025.

⁷ F03500, Mbrojtësi i Viktimave, *Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave ndaj ‘Kërkesës së Përbashkët e Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte me Shtojcën 1 konfidenciale dhe ex parte’*, 29 shtator 2025.

⁸ F03508, Mbrojtësi i Specializuar, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjeve të ZPS-së dhe Mbrojtësit të Viktimave ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes së Thaçit për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte*, 7 tetor 2025, konfidenciale (versioni i redaktuar publik i dorëzua të njëjtën ditë F03508/RED).

⁹ Kërkesa, para. 17-18.

¹⁰ Kërkesa, para. 20.

ndërmjet procedurave të përcaktuara nga Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, por jo nga Protokollin në Çështjen 12, janë kriteret e mëposhtme: dhënia e njoftimit dhjetë ditë përpara për çdo dëshmitar; që pala thirrëse të marrë pëlqimin e bazuar në informacion nga dëshmitari; që të bëhet incizimi me audio dhe video i të gjitha ndërveprimeve me dëshmitarin; që incizimi me audio dhe video të ndahet me palët e tjera dhe Trupin Gjyqësor.¹¹ Mbrojtja e Thaçit parashtron se Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 do të zbatohet për shumicën e kontakteve midis Mbrojtjes së z. Thaçi në Çështjen 12 dhe dëshmitarëve të ZPS-së në Çështjen 12.¹²

10. Mbrojtja e Thaçit parashtron se ekipet e tjera të Mbrojtjes në Çështjen 12, dhe ZPS-ja, janë të detyruar të zbatojnë kornizën më pak të rreptë të përcaktuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Çështjen 12 ("Protokollin për Kontakte në Çështjen 12"),¹³ ndërsa ekipi i Mbrojtjes së Thaçit është i detyruar të zbatojë masa më të rrepta sipas Protokollit për Kontakte në Çështjen 06 në lidhje me dëshmitarët e njëjtë.¹⁴ Mbrojtja e Thaçit argumenton se kjo krijon probleme me drejtësinë e gjyqimit për z. Thaçi në Çështjen 12, veçanërisht sa i takon barazisë midis ekipit të Mbrojtjes së Thaçit në Çështjen 12 dhe palëve të tjera në Çështjen 12.¹⁵ Mbrojtja e Thaçit parashtron se përfundimi i argumenteve të ZPS-së në Çështjen 06, ekzistenca e dy protokolleve të ndryshme, dhe kontrolli i mundshëm i disponueshëm në Çështjen 12 përbëjnë ndryshim material të rrethanave që përlligjin ndryshimin e Protokollit për Kontakte në Çështjen 06.¹⁶

11. Për rrjedhojë, Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjyqësor të ndryshojë Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 në mënyrë të tillë që kontaktet midis ekipit të Mbrojtjes së Thaçit në Çështjen 12 dhe dëshmitarëve të njëjtë të

¹¹ Kërkesa, para. 20.

¹² Kërkesa, para. 20.

¹³ Kërkesa, para. 19.

¹⁴ Kërkesa, para. 20.

¹⁵ Kërkesa, para. 20-28.

¹⁶ Kërkesa, para. 33-35, 41.

identifikuar në Shtojcën 1¹⁷ të mbulohen vetëm nga Protokollin për Kontakte në Çështjen 12 (“ndryshimet e kërkuara”).¹⁸ Sipas Mbrojtjes së Thaçit, Trupi Gjykes në Çështjen 06 është forumi i përshtatshëm për këtë Kërkesë pasi ai mund të ndryshojë Protokollin në Çështjen 06, mund të shqyrtojë pasojat e vendimeve të tij në gjykimin e drejtë, dhe është mjete juridik i fundit i disponueshëm për z. Thaçi.¹⁹

B. PËRGJIGJJA E ZPS-SË

12. ZPS-ja e kundërshton Kërkesën.²⁰ Ajo parashtron se ndryshimet e kërkuara nuk janë të përligjura për shkak se: (i) Paneli i Gjykatës së Apelit tashmë ka vendosur se Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 nuk e ngarkon në mënyrë joproporcionale Mbrojtjen e Thaçit;²¹ (ii) ndërsa Mbrojtja e Thaçit ngre çështjen e barazisë së palëve, ajo kryesisht ankohet lidhur me pozicionin e z. Thaçi në raport me të bashkakuarit e tjerë në Çështjen 12;²² (iii) Trupi Gjykes ka vendosur më parë se Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 do të zbatohet për *të gjithë* të akuzuarit në Çështjen 06;²³ dhe (iv) provat e ZPS-së lidhur me Çështjen 12 përbëhen kryesisht nga prova shkresore që shkojnë përtej dëshmime të dëshmitarëve të njëjtë.²⁴

13. Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se: (i) ekipi i Mbrojtjes së Thaçit nuk pengohet që të zhvillojë hetimet e veta brenda parametrave të Protokollit për Kontakte në Çështjen 06;²⁵ (ii) e drejta e Mbrojtjes së Thaçit për të intervistuar dëshmitarët e

¹⁷ Trupi Gjykes vë në dukje se: (i) Shtojca 1 lidhet vetëm me disa dëshmitarë të njëjtë; dhe (ii) Shtojca 1 nuk i është dhënë ZPS-së për shkak se Shtojca 1 zbulon pista të mundshme të hetimeve të Mbrojtjes. Trupi Gjykes gjithashtu vëren se Mbrojtja e Thaçit parasheh se ajo mund të parashtojë kërkesa të tjera të ngjashme me vijimin e hetimeve të saj (*shih* Kërkesën, para. 42, 43).

¹⁸ Kërkesa, para. 36-41, 44.

¹⁹ Kërkesa, para. 29-32.

²⁰ Përgjigja e ZPS-së, para. 1, 14.

²¹ Përgjigja e ZPS-së, para. 2-3.

²² Përgjigja e ZPS-së, para. 2, 4.

²³ Përgjigja e ZPS-së, para. 2, 5.

²⁴ Përgjigja e ZPS-së, para. 2, 6.

²⁵ Përgjigja e ZPS-së, para. 7.

palës kundërshtare nuk është e pakufizuar;²⁶ dhe (iii) në rrethanat e çështjes, ndryshimet e kërkuara nuk janë të përshtatshme dhe të domosdoshme.²⁷

C. PËRGJIGJJA E MBROJTËSIT TË VIKTIMAVE

14. Mbrojtësi i Viktimave gjithashtu e kundërshton Kërkesën.²⁸ Mbrojtësi i Viktimave argumenton se ndryshimet e kërkuara mund të cenojnë dëshmitarët/viktimat me status të dyfishtë të përfaqësuar nga Mbrojtësi i Viktimave në Çështjen 06.²⁹ Në këtë kontekst, ai parashtron se: (i) nevojat bazë që justifikojnë Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 nuk ndryshohen nga fakti që z. Thaçi është i përfshirë në Çështjen 12;³⁰ dhe (ii) Trupi Gjykses në Çështjen 06 nuk është përgjegjës për garantimin e të drejtës për gjykim të drejtë të z. Thaçi në Çështjen 12.³¹ Mbrojtësi i Viktimave pohon se ndryshimet e kërkuara nuk janë të përligjura dhe Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 mbetet i domosdoshëm dhe i përshtatshëm.³²

D. KUNDËRPËRGJIGJJA

15. Mbrojtja rithekson se rrethanat kanë ndryshuar për shkak se Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 dhe Trupi Gjykses aktual është forumi i duhur për Kërkesën.³³ Ajo shton se: (i) ZPS-ja nuk trajton faktin se Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 përcakton dy grupe të ndryshme rregullash sa i takon kontakteve me dëshmitarët midis ZPS-së dhe Mbrojtjes së Thaçit në Çështjen 12;³⁴ (ii) as ZPS-ja as Mbrojtësi i Viktimave nuk shpjegojnë pse ekipi i Mbrojtjes së Thaçit përbën kërcënim dhe ekipet e Mbrojtjes së të akuzuarve

²⁶ Përgjigjja e ZPS-së, para. 7.

²⁷ Përgjigjja e ZPS-së, para. 8-13.

²⁸ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 25.

²⁹ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 1, 3.

³⁰ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12, 19.

³¹ Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 10.

³² Përgjigjja e Mbrojtësit të Viktimave, para. 24.

³³ Kundërpërgjigjja, para. 10, 17-19.

³⁴ Kundërpërgjigjja para. 3-4.

të tjerë në Çështjen 12 nuk përbëjnë kërcënim;³⁵ (iii) ndërsa ZPS-ja zvogëlon rëndësinë e provave të dëshmitarëve të njëjtë, të paktën njëri prej këtyre dëshmitarëve deklaroi se ai nuk është kontaktuar nga të bashkakuzuarit e tjerë në Çështjen 12;³⁶ (iv) as ZPS-ja as Mbrojtësi i Viktimave nuk trajtojnë faktin se Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka vlerësuar se masat në Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 nuk janë të nevojshme për mbrojtjen e dëshmitarëve të njëjtë kur kontakti ndodh përmes Mbrojtjes dhe për arsye të hetimeve në Çështjen 12;³⁷ dhe (v) dëshmitarët e njëjtë nuk janë viktimat pjesëmarrëse në Çështjen 12 dhe Mbrojtësi i Viktimave përfaqëson vetëm viktimat për qëllime të Çështjes 06, jo të Çështjes 12.³⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

16. Dispozitat relevante të Protokollit për Kontakte në Çështjen 06, të konfirmuara nga Paneli i Gjykatës së Apelit, parashohin si më poshtë:³⁹

II. Kontaktet midis një pale ose pjesëmarrësi me dëshmitarët e palës ose pjesëmarrësit kundërshtar

[...]

- b.** Në qoftë se dëshiron të intervistojë një dëshmitar të palës apo të pjesëmarrësit tjetër, pala ose pjesëmarrësi kundërshtar informon palën thirrëse dhe Njësinë e Administrimit të Gjykatës ("NJAGJ") dhe, në rastin e dëshmitarëve me status të dyfishtë, Mbrojtësin e Viktimave, të paktën dhjetë ditë para intervistës së synuar. Pala thirrëse verifikon me ndershmëri nëse dëshmitari jep pëlqimin të intervistohet nga pala kundërshtare dhe gjithashtu informon dëshmitarin për mundësinë e pranisë në intervistë të përfaqësuesit të palës thirrëse, përfaqësuesit ligjor të dëshmitarit, Mbrojtësit të Viktimave në rastin e dëshmitarëve me status të dyfishtë, dhe/ose të përfaqësuesit të ZMMD-së. Në rrethana të veçanta, pasi të jetë këshilluar mjaftueshëm paraprakisht me Zyrën Administrative, pala ose pjesëmarrësi mund t'i drejtohet Panelit që të kërkojë edhe praninë e një përfaqësuesi të Zyrës Administrative. Pala thirrëse informon palën kundërshtare nëse dëshmitari jep pëlqimin. Gjithashtu, në rast

³⁵Kundërpërgjigjja para. 5-7.

³⁶Kundërpërgjigjja para. 8-9.

³⁷Kundërpërgjigjja para. 11-16.

³⁸Kundërpërgjigjja para. 20-24.

³⁹Vendimi i Apelit lidhur me Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 106.

se beson se siguria e dëshmitarit mund të jetë të rrezikuar, ose për arsye të tjera legjitime, pala thirrëse mund t'i kërkojë panelit ta lejojë të jetë e pranishme në takimet mes palës kundërshtare dhe dëshmitarit, pavarësisht nga parapëlqimi i shprehur prej dëshmitarit. Kur pala thirrëse parashtron para panelit apo i vë në dukje palës kundërshtare se do ta bëjë këtë, pala kundërshtare nuk e interviston dëshmitarin para lëshimit të vendimit nga paneli. Procedura e kësaj pjese nuk zbatohet për intervistat e kryera nga ZPS-ja me dëshmitarë të palës kundërshtare që lidhen me çështje të tjera gjyqësore, përveçse kur ZPS-ja planifikon që në ato intervista të bëjë pyetje që kanë lidhje me akuzat në këtë çështje gjyqësore.

[...]

d. [Pala intervistuese]:

iii. nuk bisedon me dëshmitarin jashtë kuadrit të intervistës dhe të incizimit me video, në mënyrë që të gjitha deklaratat dhe çdo gjë që thuhet të evidentohen si duhet;

[...]

j. Gjatë intervistës, pala intervistuese:

[...]

iv. siguron që intervista të incizohet me audio dhe video;

[...]

n. Pas përfundimit të intervistës, pala intervistuese përgatit:

[...]

ii) incizimin me audio dhe video të intervistës, kopje të të cilit ua dorëzon palëve dhe Panelit.

17. Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 vazhdon të zbatohet edhe pasi dëshmitari jep dëshminë, ose deklarata e dëshmitarit është pranuar si provë sipas rregullës 153 ose 155, në Çështjen 06.⁴⁰

18. Dispozitat relevante të Protokollit për Kontakte në Çështjen 12⁴¹ parashohin:

Pjesa II: Kontaktet midis një pale me dëshmitarët e palës kundërshtare

a. Të akuzuarit nuk do të vendosin kontakte, të drejtpërdrejta ose të tërthorta (përmes një personi tjetër, përveç mbrojtësve), të asnjë lloji dhe mënyre, me

⁴⁰Vendimi i Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 26(b).

⁴¹ KSC-BC-2023-12, F00295/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Masat Mbrojtëse dhe Trajtimin e Informacionit Paraprak dhe Kontakteve me Dëshmitarët*, 12 maj 2025, para. 46.

- dëshmitarë apo viktimat të çështjes gjyqësore aktuale apo të çdo çështjeje tjetër para DHS-së për identitetin e të cilëve është njoftuar Mbrojtja.
- b. Urdhri i mësipërm nuk përfshin dëshmitarët apo viktimat e çështjeve të tjera para DHS-së për identitetin e të cilëve nuk është njoftuar Mbrojtja.
 - c. Mbrojtja informon ZPS-në dhe Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") të paktën dhjetë ditë para intervistës së synuar nëse Mbrojtja dëshiron të kontaktojë dhe/ose intervistojë ndonjë dëshmitar të Grupit B, siç identifikohet në F00172, para. 43(e). Pas njoftimit, ZPS-ja, në konsultim me ZMMD-në, i jep Mbrojtjes çdo informacion nëse dëshmitari ka ndonjë nevojë të veçantë siç përcaktohet në rregullën 146 të Rregullores ose nëse kërkon masa të posaçme siç përcaktohet në rregullën 80(4)(c) të Rregullores, ose me çdo informacion tjetër përkatës.

IV. DISKUTIM

19. Fillimisht, Trupi Gjykses vëren se Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe Trupi Gjykses që do të emërohet për gjykimin e Çështjes 12, kanë përgjegjësi në lidhje me mbrojtjen efektive të të drejtave themelore të z. Thaçi në Çështjen 12. Megjithatë, duke qenë se Kërkesa ka të bëjë me zbatimin e Protokollit për Kontakte në Çështjen 06, Trupi Gjykses konsideron se Mbrojtja e Thaçit e paraqiti Kërkesën në mënyrë të duhur para këtij Trupi Gjykses.

20. Lidhur me fushëveprimin e Kërkesës, Mbrojtja e Thaçit argumenton se, për aq sa pretendohet se z. Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tjerë në Çështjen 12 kanë ndërhyrë ndaj dëshmitarëve të njëjtë, këta dëshmitarë mund të jenë në gjendje të japin prova relevante për argumentet e z. Thaçi në Çështjen 12. Megjithatë, ZPS-ja pohon se provat që me gjasë do të paraqesë në gjykim në Çështjen 12 përfshijnë, në një masë të konsiderueshme, incizime të bisedave të z. Thaçi në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") dhe materiale të tjera të sekuestruara nga z. Thaçi dhe të bashkakuzuarit e tjerë në Çështjen 12.⁴² Pavarësisht kësaj, duke vënë në dukje pretendimin e Mbrojtjes së Thaçit se të paktën një dëshmitar i njëjtë deklaroi se nuk ishte kontaktuar nga të

⁴² *Shih* Vendimin e Konfirmimit për Çështjen 12. *Shih gjithashtu*, F03216, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Materialeve të lidhura me Pengimin*, 29 maj 2025, konfidencial,(versioni i redaktuar publik u lëshua më 26 gusht 2025, F03216/RED).

bashkakuzuarit e Çështjes 12 për aspekte që lidhen me pengimin e drejtësisë,⁴³ Trupi Gjykses gjykon se ndryshimet e kërkuara mbështeten nga një interes legjitim forenzik. Kjo nuk paragjykon pyetjen nëse një informacion i tillë do të ishte relevant për Çështjen 12 dhe, nëse po, për çfarë qëllimi. Këto aspekte duhet të vendosen nga Trupi Gjykses në Çështjen 12.

21. Lidhur me aspektet e pretenduara të barazisë së palëve në raport me ZPS-në, Trupi Gjykses kujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se Protokollit për Kontakte në Çështjen 06 nuk e ngarkon në mënyrë joproporcionale Mbrojtjen, pasi ai zbatohet në mënyrë të barabartë për të dyja palët.⁴⁴ Trupi Gjykses konsideron se fakti që ZPS-ja mund të jetë në gjendje të kontaktojë dëshmitarët që do të thirren nga ekipi i Mbrojtjes së Thaçit në Çështjen 12 përtej parametrave të Protokollit për Kontakte në Çështjen 06 nuk i cenon këto konstatime.⁴⁵ Ajo që ka rëndësi është që të dyja Palët në parim i nënshtrohen të njëjtave kufizimeve dhe kushteve në lidhje me kontaktet e tyre me dëshmitarët në Çështjen 06 sipas Protokollit përkatës,⁴⁶ në mënyrë që të ruhet barazia e palëve në këtë çështje.

22. Trupi Gjykses vëren në këtë drejtim se Protokollit për Kontakte në Çështjen 06 nuk zbatohet për kontaktet e Mbrojtjes së Thaçit me dëshmitarët e ZPS-së në Çështjen 12 të cilët nuk janë dëshmitarë në Çështjen 06. Protokollit për Kontakte në Çështjen 06 nuk është detyruar për kontaktet midis Mbrojtjes së Thaçit dhe atyre dëshmitarëve. Gjithashtu, fakti që dëshmitarët e Mbrojtjes së Thaçit në Çështjen 06 nuk kanë relevancë për Çështjen 12 nuk është bazë për të pretenduar shkelje të barazisë së palëve. Barazia e palëve nuk mbështetet në numrin e dëshmitarëve

⁴³ Kundërpërgjigjja, para. 9.

⁴⁴ Vendimi i Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 77. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 120. Vendimi për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte në Çështjen 06, para. 21

⁴⁵Kërkesa, para. 24.

⁴⁶*Shih* Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, Seksioni II(b), “[...] Procedura e kësaj pjese nuk zbatohet për intervistat e kryera nga ZPS-ja me dëshmitarë të palës kundërshtare lidhur me çështje të tjera gjyqësore, përveçse kur ZPS-ja planifikon që në ato intervista të bëjë pyetje që janë relevante për akuzat në këtë çështje gjyqësore”, siç citohet më lart në para. 16.

relevantë që përfshihen ose jo në një protokoll të caktuar. Barazia e palëve bazohet në faktin që secila palë të ketë një mundësi të arsyeshme për të paraqitur argumentet e veta pa qenë në pozitë të pafavorshme të konsiderueshme në raport me kundërshtarin e saj.⁴⁷ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja e Thaçit nuk pretendon se është penguar të kryejë hetimet e saj në Çështjen 12 në lidhje me dëshmitarët e njëjtë brenda parametrave të Protokollit për Kontakte në Çështjen 06. Trupi Gjykses kujton konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, kur konfirmoi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, se e drejta për të intervistuar një dëshmitar të një pale kundërshtare nuk është e pakufizuar.⁴⁸ Trupi Gjykses konsideron se konstatimi i Panelit të Gjykatës së Apelit se Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 nuk e ngarkon në mënyrë joproporcionale Mbrojtjen⁴⁹ mbetet i pandryshuar.

23. Sa i takon pabarazisë së pretenduar të palëve në raport me ekipet e tjera të Mbrojtjes në Çështjen 12, Trupi Gjykses vëren se parimi i barazisë së palëve është një garanci themelore që zbatohet midis palëve kundërshtare.⁵⁰ Rrjedhimisht, ai nuk duhet të matet në raport me të bashkakupuarit ose ekipet e tyre të Mbrojtjes. Gjithashtu, ky Grup Gjykses nuk ka asnjë tregues para tij se ndonjë nga ekipet e tjera të Mbrojtjes ka kërkuar të kontaktojë ndonjë dëshmitar të Çështjes 06. Trupi Gjykses arrin në përfundimin se nuk është vërtetuar asnjë shkelje e parimit të barazisë së palëve dhe çdo ndikim negativ në të ardhmen lidhur me aftësinë e

⁴⁷Shih Vendimin e Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 77. Shih gjithashtu ECtHR, *Letellier v. France*, no. 22209/93, Judgment, 26 June 1991, para. 34; *Shih për ngjashmëri*, KSC-CC-PR-2017-01/F00004, Paneli i Gjykatës Kushtetuese, [Judgment on the Referral of the Rules of Procedure and Evidence Pursuant to Article 19\(5\) of the Law](#) (Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas Nenit 19(5) të Ligjit) (“Aktvendimi i Panelit të Gjykatës Kushtetuese”), 26 prill 2017, para. 27.

⁴⁸Vendimi i Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 79.

⁴⁹Shih më lart, para. 21.

⁵⁰Shih Vendimin e Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 77, me referenca. *Shih ngjashëm*, Aktvendimin e Panelit të Gjykatës Kushtetuese, para. 27. Shih gjithashtu ECtHR, *Gregaçević v. Croatia*, no. 58331/09, [Judgment](#), 10 July 2012, para. 50. ECtHR, *Clooth v. Belgium*, no. 32576/96, [Judgment](#), para. 32. ECtHR, *Kress v. France*, Case no. 39594/98, [Judgment](#), para. 72; ICTY, *The Prosecutor v. Duško Tadić*, Case no. IT-94-1-A, [Appeals Judgment](#), 17 July 1999, para. 44; ICTR, *The Prosecutor v. Clément Kayishema et al.*, Case no. ICTR-95-1-A, [Judgment](#).

Mbrojtjes së Thaçit për të kryer hetimet e saj është hipotetik dhe spekulativ në këtë pikë.

24. Trupi Gjykses vë në dukje se Mbrojtja e Thaçit: (i) konsideron se “ka ndryshim material të rrethanave që nga Vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit, që ka ndikim në bazën mbi të cilën është marrë vendimi”; dhe (ii) ka kërkuar mjetin e duhur juridik nga Trupi Gjykses, siç përcaktohet në paragrafin 71 të Urdhrit për Zhvillimin e Gjykimit. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses kujton se, kur Paneli i Gjykatës së Apelit konfirmoi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, ai mori parasysh, ndër të tjera, natyrën parandaluese të kësaj kornize,⁵¹ të cilën Paneli i Gjykatës së Apelit e konsideroi si një faktor të rëndësishëm që justifikon Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, pavarësisht ndonjë incidenti konkret të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.⁵² Trupi Gjykses kujton konstatimet e tij të mëparshme se procesi gjyqësor aktual është zhvilluar në një klimë ndërhyrjeje dhe frikësimi ndaj dëshmitarëve, dhe rreziku i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve në Çështjen 06, ose i tërheqjes së dëshmimeve nga dëshmitarët, nuk mund të eliminohet plotësisht, edhe pasi dëshmitarët të kenë dëshmuar.⁵³

25. Trupi Gjykses vë në dukje gjithashtu se, që prej vendimit të Panelit të Gjykatës së Apelit: (i) z. Thaçi është akuzuar për vepra penale të lidhura me ndërhyrjen ndaj dëshmitarëve dhe procesit në Çështjen 06, në veçanti në lidhje me

⁵¹Vendimi i Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 34, 45.

⁵²Vendimi i Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 34, 45.

⁵³Midis shumë vendimeve të tjera, Vendimi për Ndryshimin e Protokollit për Kontakte në Çështjen 06, para. 20; F03514, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 10 tetor 2025, para. 20-23. *Shih gjithashtu* IA035/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës në lidhje me Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe Rishikimin e Paraburgimit*, 14 gusht 2025, publik, para. 34; KSC-BC-2023-12, F00382/COR/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Kushteve të Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 18 korrik 2025, para. 28-29; KSC-BC-2023-12, F00476, *Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Hashim Thaçit*, 3 tetor 2025, para. 19, ku Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se rreziku i pengimit vazhdon të ekzistojë pavarësisht përfundimit të argumenteve të ZPS-së në Çështjen 06 pasi: (i) procesi gjyqësor nuk ka përfunduar ende, (ii) në rrethana të jashtëzakonshme, një trup gjykses mund të dëgjojë dëshmi shtesë pas përfundimit të paraqitjes së provave; dhe (iii) dëshmitarët që tashmë kanë dhënë dëshmi mund të jenë objekt hakmarrjeje ose të nxiten të tërheqin dëshminë e tyre.

dëshmitarët e njëjtë; (ii) procesi gjyqësor në Çështjen 06 nuk ka përfunduar ende; dhe (iii) dëshmitarët e njëjtë, si çdo dëshmitar tjetër, mund të jenë objekt i një kërkesë të ZPS-së për paraqitjen e kundërprovave. Trupi Gjykes gjykon se nevoja për ofrimin e garancive dhe mbrojtjes së përfshirë në Protokollin për Kontakte në Çështjen 06 vazhdon të ekzistojë dhe të zbatohet në këtë çështje gjyqësore.

26. Sa i takon garancive të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me detyrimet e Mbrojtjes sipas kodeve të etikës së vendit dhe të DHS-së,⁵⁴ Trupi Gjykes vë në dukje se ky argument u hodh poshtë nga Paneli i Gjykatës së Apelit.⁵⁵ Gjithashtu, ai nuk cenon materialisht asnjë nga konstatimet e bëra më lart.

27. Trupi Gjykes vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duket se ka deduktuar se kontaktet nga Mbrojtja në Çështjen 12 nuk do të përbënin rreziqe për dëshmitarët e njëjtë.⁵⁶ Megjithatë, Trupi Gjykes vë në dukje se Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në këtë përfundim pasi mori parasysh: (i) elementët që iu paraqitën nga ZPS-ja në lidhje me Çështjen 12; (ii) fazën në të cilën ndodhet procesi gjyqësor; dhe (iii) në lidhje me ato procedura për të cilat është përgjegjëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake (d.m.th., Çështja 12).⁵⁷ Është përgjegjësi e këtij Trupi Gjykes, jo e Gjykatësës së Procedurës Paraprake, të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve në Çështjen 06 në kontekstin e këtij procesi gjyqësor. Trupi Gjykes nuk mund t'ia delegojë këto përgjegjësi një gjykatësi tjetër, dhe as nuk e kupton që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të ketë sugjeruar ndryshe.

28. Duke marrë parasysh konstatimet në paragrafët 24-26, Trupi Gjykes gjykon se nuk ka ndonjë ndryshim material të rrethanave që do të cenonte konstatimin e Panelit të Gjykatës së Apelit se masat mbrojtëse të përcaktuara në Protokollin për

⁵⁴*Shih më lart*, para. 15.

⁵⁵Vendimi i Apelit mbi Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, para. 33.

⁵⁶*Shih* Kundërpërgjigjen, para. 11-14, Trupi Gjykes deduktonte se dëshmitarët e referuar si dëshmitarë të "Grupit B" përfshijnë ose janë "dëshmitarë të njëjtë."

⁵⁷*Shih* Kundërpërgjigjen, para. 12, që i referohet KSC-BC-2023-12, F00295/RED, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Masat Mbrojtëse dhe Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarët, 12 maj 2025, para. 38.

Kontakte në Çështjen 06 janë të nevojshme përtej detyrimeve të përcaktuara tashmë në kodet e etikës së vendit dhe të DHS-së.

29. Për këto arsye, Trupi Gjykes refuzon të ndryshojë Protokollin për Kontakte në Çështjen 06, siç kërkohet nga Mbrojtja e Thaçit.

V. VENDIM

30. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykes **RRËZON** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatësi Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 23 tetor 2025

Në Hagë, Holandë.